



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.96/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Dren Rogova, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit F... Shpk me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.746/17 të datës 13.01.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 01.02.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.746/17 i datës 13.01.2020, Vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.746/17 të datës 13.01.2020, nën pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit është aprovuar pjesërisht Kërkesëpadia e paditësit F... Shpk me seli në Prishtinë, nën pikën II. Anulohet aktvendimi me nr.06.2/77,128,176 i datës 27.03.2017 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, nën pikën III. obligohet e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit F... Shpk me seli në Prishtinë, t'ia kthej shumën prej 4,412.21€ (katër mijë e katër qind e dymbëdhjetë euro e njëzetë e një cent) të paguar më tepër si pasoj e rivlerësimit të mallit, në emër të detyrimeve importuese doganore për mallin e importuar përmes Deklaratave doganore R-421/14.01.2017, R-764/21.01.2017, R-1623/03.02.2017, R-2864/21.02.2017 të Zyrës Doganore Hani Elezit, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Në pikën IV. Refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumën e aprovuar, përkatësisht shuma prej 3.01€ (tre euro e një cent), si e pa bazuar. Ndërsa nën pikën V. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura Dogana e Kosovës, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa në tërësi si e bazuar në ligj, të prishet aktgjykimi A.nr.746/17 datë 13.01.2020 si të pa bazuar me ligj, të refuzon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si e pa bazuar me ligj, dhe të lë në fuqi vendimin e kontestuar, ose t'ia kthen gjykatës së shkallës së parë në rivendosje. Qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar dhe jo i bazuar në dispozita ligjore. Në bazë të dispozitave ligjore kompetenca për caktimin e vlerës së mallrave të importuara është në kompetencë të Doganës së Kosovës, në procedurë doganore, sipas dispozitave të Kodit Doganor të Kosovës. Nga deklaratat doganore shihet se deklaruesi i mallit-paditësi ka deklaruar mallin në fjalë, por me çmim më të ulët dhe se Dogana e Kosovës ka disponuar të dhëna për mallin në fjalë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.06.2/77,128,176 të datës 27.03.2017 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë F... Shpk me seli në Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimeve R-421/14.01.2017, R-764/21.01.2017, R-1623/03.02.2017, R-2864/21.02.2017 të Zyrës Doganore Hani Elezit.

Paditësi ndaj këtij vendimi administrativ përfundimtar në procedurën administrative të ankesave, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 25.04.2017, me të cilën ka inicuar konflikt administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, respektivisht ka kundërshtuar vendimin administrativ, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr. 06.2/77, 128, 176 të datës 27.03.2017, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon pjesërisht si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimin. Në arsyetim të aktgjykimin gjykata thekson se e paditura pa bazë ligjore dhe pa prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të paditësit për DUD-at R-421/14.01.2017, R-764/21.01.2017, R-1623/03.02.2017, R-2864/21.02.2017 të Zyrës Doganore Hani Elezit. Gjykata konstaton se paditësi në procedurë administrative të e paditura por edhe para gjykatës ka paraqit dokumentacionet përcjellëse të mallit lëndor të cilat rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar në kuptim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave. Paditësi ka paraqitur faturat dhe transaksionet bankare me të cilat dëshmohet çmimi i paguar i mallit me qëllim eksporti në Kosovë.

Dhoma e Shkallës së Dytë, e vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe nenit 81 G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në drejtim të pretendimeve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar dhe jo i bazuar në dispozita ligjore, se në bazë të dispozitave ligjore kompetenca për caktimin e vlerës së mallrave të importuara është në kompetencë të Doganës së Kosovës, në procedurë doganore, sipas dispozitave të Kodit Doganor të Kosovës. Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, meqë gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka zbatuar ligjin, duke aplikuar dispozitat e nenit 81G të Ligjit 04/L-102, dhe nenin 46 paragrafi 2 të LKA-së, kur me aktgjykimin ankimor ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit. Gjithashtu Kolegji vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka autorizime ligjore nga neni 81I paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën tatimore dhe Procedurat 03/L-202, të vendos për padinë.

Kolegji nuk i aprovoi si të bazuara pretendimet e palës së paditur, se nga Deklaratat doganore shihet se deklaruesi i mallit-paditësi ka deklaruar mallin në fjalë, por me çmim më të ult dhe se Dogana e Kosovës ka disponuar të dhëna për mallin në fjalë. Kolegji pranon konstatimet e dhëna në arsyetimin e aktgjykimit ankimor se e paditura në asnjë moment nuk ka qenë në gjendje të provojë pretendimin se paditësi për mallin lëndor të importuar, i ka paguar eksportuesit të mallit nga Bullgaria B...B...E..., mbi çmimin e faturave të mallit. Prandaj Kolegji vlerëson se e paditura ka pasur obligim ligjor që paraprakisht të shqyrtoj bazën ligjore nga neni 33 i Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L-109, për të vërtetuar se a janë plotësuar kushtet ligjore për tu pranuar vlera e transaksionit, e më pastaj ti përdor metodat e tjera të vlerësimit, përderisa në rastin konkret e paditura nuk vlerëson asnjë provë materiale që i ka bashkangjitur paditësi ankesës në procedurën administrative të ankesave. Prandaj, edhe Kolegji, vlerëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor në pajtim me nenin 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr. 03/L-109.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të pjesërishëm të kërkesëpadisë së paditësit, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.96/22 datë 01.02.2023

Kryetar i kolegjit,
Krenar Berisha